

Udhëzues për përpunimin e të dhënave personale në sektorë specifike në kuadër të masave kundër COVID-19

Zyra e Komisionerit, në vijim të publikimit të “Udhëzuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19”, të datës 20.03.2020, i cili përmban disa orientime të rëndësishme për kontrolluesit publik dhe privat lidhur me respektimin e parimeve dhe kriterëve ligjore të përpunimit të të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19, si dhe në përgjigje të interesit dhe shqetësimit të shtuar publik – qoftë nëpërmjet artikullimit mediatik, apo pyetjeve të drejtpërdrejta të qytetarëve të caktuar – sa i përket fushave specifike të përpunimit të të dhënave personale (veçanërisht, të atyre që lidhen me shëndetin), nëpërmjet këtij udhëzuesi, sjell në vëmendjen e çdo pale të interesuar disa aspekte konkrete në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sektorë të caktuar.

Këto aspekte trajtojnë përpunimin e të dhënave personale, në kuadër të masave kundër COVID-19, në sektorë si punësimi, telekomunikacioni, shëndetësia dhe arsimi.

Vlen të ritheksohet, në mënyrë aksiomatike, fakti se përpunimi i të dhënave personale në luftën kundër COVID-19 nuk përbën shkak për kufizimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve në tejkalim të parashikimeve detyruese të paragrafit 2 të nenit 175 të Kushtetutës.

Nga ana tjetër, legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale nuk pengon dhe/ose kufizon të drejtat dhe detyrimet e kontrolluesve lidhur me përpunimin e të dhënave personale në kuadër të luftës kundër COVID-19.

Më tej, Zyra e Komisionerit dëshiron të theksojë se aspektet e trajtuara në këtë udhëzues burojnë nga interpretimi i drejtë i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe, gjithashtu, janë në sintoni të plotë me qëndrimet e institucioneve homologe të Bashkimit Evropian (BE) dhe Këshillit të Evropës (KiE), si dhe në frymën e kuadrit rregullator të BE dhe instrumenteve të KiE me objekt dhe fokus mbrojtjen e të dhënave personale.

I. Përpunimi i të dhënave personale nga punëdhënësit

Në kushtet e situatës së pazakontë dhe të vështirë të shkaktuar nga përhapja e COVID-19, punëdhënësit po ballafaqohen me vështirësi dhe pikëpyetje gjithnjë e më të mëdha lidhur me përpunimin e të dhënave të punëmarrësve.

Në kuadër të masave parandaluese kundër COVID-19, një pjesë e punëdhënësve kanë vendosur të mbajnë të angazhuar personelin nëpërmjet punës në shtëpi ose telepunës¹.

Kategori të tjera punëdhënësish, për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre, vijojnë të angazhojnë punëmarrësit e tyre në vendet normale të punës dhe, krahas masave higjeno-sanitare dhe sigurimit

¹ Neni 15 i ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

të distancimit social në ambientet përkatëse, gjenden në kushtet e monitorimit të vazhdueshëm të gjendjes shëndetësore të punëmarrësve të tyre, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Në lidhje me sa më sipër, punëmarrësit janë, ndër të tjera, subjekt i kontrollit të vazhdueshëm në lidhje me konstatimin në kohë të simptomave eventuale të COVID-19, si dhe monitorimit me sistemet e video survejimit lidhur me respektimin e masave higjieno-sanitare.

Gjithashtu, punëmarrësit e angazhuar nëpërmjet punës në shtëpi apo telepunës, aksesojnë platformat e punëdhënësve nëpërmjet rrjeteve private virtuale (VPN), ose përdorin kanale private komunikimi (si adresat elektronike personale), etj.

Në këto rrethana, Zyra e Komisionerit sqaron se për qëllime të masave kundër COVID-19, parimisht, punëdhënësit mund të përpunojnë të dhëna personale të punëmarrësve (siç janë të dhënat e përfuara nga monitorimi i shtuar i shëndetit të tyre), në sasi dhe cilësi që – në mënyrë të arsyeshme – tejkalojnë përpunimin e zakonshëm të të dhënave në fjalë në kushte normale pune.

Përpunimi përfshin jo vetëm mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të përpunuara lidhur me shëndetin, por edhe transmetimin e tyre tek organet ligjzbatuese të ngarkuara në luftën kundër COVID-19, përfshirë, por pa u kufizuar, organet e autorizuara me ligj për kryerjen e survejancës epidemiologjike (siç parashikohet nga legjislacioni në fushën e parandalimit të sëmundjeve infektive).

Nga ana tjetër, përpunimi në fjalë duhet të kryhet në përputhje me parimet dhe kriteret e përpunimit të të dhënave personale të parashikuara, përkatësisht, në nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar² (“*Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”).

Gjithashtu, përdorimi i rrjeteve private virtuale (VPN), si dhe kanaleve të tjera private të komunikimit, për qëllime të mundësimit punës në shtëpi ose telepunës, si dhe përdorimi i sistemeve të video survejimit për monitorimin e respektimit të rregullave higjieno-sanitare, krahas dispozitave të sipërpërmendura, duhet të shoqërohet edhe me masa tekniko-organizative dhe rregulla strikte që të mund të sigurohet pacënueshmëria dhe konfidencialiteti i të dhënave, në përputhje me nenet 27 dhe 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për qëllimet e sipërpërmendura, Zyra e Komisionerit apelon që të gjithë kontrolluesit të veprojnë, gjithashtu, në përputhje me aktet nënligjore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (“*Komisioneri*”), veçanërisht në udhëzimet nr. 3, 11, 22, 24, 47 dhe 49 të Komisionerit³.

Në këtë kontekst, kontrolluesit janë të detyruar të minimizojnë çdo rrezik që mund të sjellë përpunimi i kategorive përkatëse të të dhënave personale në situatën aktuale, veçanërisht rreziqet që përpunimi në fjalë mund të paraqesë ndaj dinjitetit të njeriut dhe cenimit të jetës private, si dhe

² Më konkretisht për këtë, referojuni “*Udhëzuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19*”, të datës 20.03.2020, të publikuar në faqen zyrtare të internetit www.idp.al.

³ Aktet nënligjore të Komisionerit janë të publikuara, në format të përditësuar, në faqen zyrtare të internetit www.idp.al

të marrin masa për t'u kthyer në gjendje përpunimi “normal” të të dhënave personale (përfshirë këtu, sipas rastit, fshirjen e përhershme të të dhënave të përpunuara), pasi gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe, bashkë me të, përhapja e COVID-19 të ketë përfunduar.

Në veçanti, punëdhënësit nuk duhet të përpunojnë të dhëna personale përtej asaj që është e nevojshme për qëllime të zbatimit të masave kundër COVID-19. Përpunimi i të dhënave personale duhet të realizohet proporcionalisht me qëllimin e përpunimit, si dhe për atë sa përpunimi është i përshtatshëm, i domosdoshëm dhe sjell më shumë avantazhe sesa disavantazhe, për realizimin e qëllimit në fjalë.

II. Transmetimi i të dhënave për vendndodhjen të përpunuara në rrjetet e komunikimeve elektronike

Një nga format që po përdoret aktualisht në vende të ndryshme të botës, lidhur me parandalimin e përhapjes së COVID-19, është gjurmimi i kontakteve (*contact tracing*) nëpërmjet transmetimit të të dhënave për vendndodhjen e individëve, të përfuara nga operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

Analizimi i trendeve të të dhënave për vendndodhjen (“*location data*”) po përdoret si mjet për përballimin me sukses të krizës së shkaktuar nga COVID-19.

Të dhënat për vendndodhjen nënkuptojnë çdo të dhënë të përpunuar në një rrjet të komunikimeve elektronike, që tregon pozicionin gjeografik të pajisjes fundore (celular, tablet, etj.) të një përdoruesi të rrjetit të komunikimeve elektronike⁴. Këto të dhëna përfshijnë informacione konkrete për mënyrën se si pajisjet dhe njerëzit lëvizin në hapësirë kohë pas kohe.

Zyra e Komisionerit, në përputhje me praktikën dhe qëndrimin e mbajtur në vendet e BE në lidhje me këtë aspekt, si dhe në frymën e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerëson se operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike, përpara transmetimit të të dhënave të vendndodhjes duhet të bëjnë një analizë të ndikimit që ky lloj përpunimi ka në jetën private të qytetarëve.

Veçanërisht i rëndësishëm në këtë aspekt është ruajtja e balancës midis nevojës që paraprin qëllimin për përpunim të të dhënave të vendndodhjes në kuadër të masave kundër COVID-19, si dhe sasisë, cilësisë dhe formatit të këtyre të dhënave.

Kështu, Zyra e Komisionerit gjykon se transmetimi i të dhënave të vendndodhjes i realizuar në mënyrë të agreguar dhe anonimizuar – p.sh. për të sinjalizuar raste të shkeljes së masave të distancimit social, ose për të treguar lëvizje të individëve për të vajtur, apo për t'u larguar nga zona të infektuara – siç mund të paraqitet e nevojshme në kuadër të masave për parandalimin e COVID-19, apo në kuadër të survejancës epidemiologjike, nuk përbën shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

⁴ Përkufizim sipas pikës 56 të nenit 3 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në çdo rast, përpunimi i të dhënave në fjalë duhet të realizohet në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.⁵

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit sqaron se, në çdo rast, detyrimi për përpunimin të të dhënave të vendndodhjes në përputhje me dispozitat ligjore të sipërpërmendura, nuk prek detyrimet e operatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike për të vepruar në përputhje me dispozitat e legjislationit sektorial.

Bazuar nga praktika e ndjekur deri më tani në vendet e BE, Zyra e Komisionerit, në çdo rast, vlerëson se përpunimi i të dhënave personale në shkallë të gjerë (pavarësisht agregimit dhe anonimizimit të tyre) mund të kryhet, parimisht, vetëm kur – mbi bazën e provave shkencore – përfitimet e mundshme në kuadër të garantimit të shëndetit publik nga një mbikëqyrje digjitale epidemiologjike (p.sh. gjurmimi i kontakteve), duke përfshirë saktësinë e tyre, tejkalojnë (pra, janë më të mëdha se) përfitimet që mund të burojnë nga zgjidhje të tjera alternative, të cilat do të ishin më pak ndërhyrëse në jetën private.

Teksa informacioni në kohë reale për përhapjen e COVID-19 mund të jetë i dobishëm për izolimin e tij, është e rëndësishme të theksohet se, në këto raste, është gjithsesi e preferueshme të aplikohen zgjidhjet teknike më pak ndërhyrëse në jetën private.

Siç theksohet më sipër, zhvillimi dhe aplikimi i këtyre mënyrave të mbikëqyrjes duhet të bazohet në një vlerësim paraprak të ndikimit të mundshëm të përpunimit të të dhënave që synohen të mblidhen në të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Për këtë arsye, edhe procesi përpunues i të dhënave personale duhet të konceptohet dhe kryhet në një mënyrë të tillë që të parandalojë ose minimizojë rrezikun e ndërhyrjes në të drejtat dhe liritë themelore.

III. Përpunimi i të dhënave në kuadër të survejancës epidemiologjike

Zyra e Komisionerit sqaron se përpunimi i të dhënave në kuadër të survejancës epidemiologjike⁶ siç parashikohet në ligjin nr. 15/2016, datë 10.03.2016 “*Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive*” (“*Ligji 15/2016*”) nuk pengohet dhe/ose kufizohet nga dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kështu, ngjarjet si përhapja e COVID-19, të cilat përbëjnë kërcënime serioze për shëndetin dhe jetën e qytetarëve, kërkojnë masa kontrolli të veçanta apo të lidhura me gjurmimin e kontakteve në mënyrë të koordinuar, për të identifikuar persona që mund të jenë të infektuar apo të ekspozuar ndaj rrezikut të infektimit.

⁵ Më konkretisht për këtë, referojuni “*Udhëzuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19*”, të datës 20.03.2020, të publikuar në faqen zyrtare të internetit www.idp.al.

⁶ Në bazë të pikës 42 të nenit 3 të ligjit 15/2016, “*Survejanca epidemiologjike*” është grumbullimi sistematik, regjistrimi, analiza, interpretimi dhe shpërndarja e të dhënave dhe analizës për sëmundjet infektive dhe çështje të tjera shëndetësore të lidhura me to, në mënyrë të vazhdueshme, për të fituar njohuri për sëmundjen, përhapjen e saj dhe për të ndërmarrë veprime për ta eliminuar, zhdukur, kontrolluar dhe parandaluar atë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se organet e ngarkuara me marrjen e masave në kuadër të survejancës epidemiologjike në luftën kundër COVID-19 janë ligjërisht të autorizuar të përpunojnë të dhënat personale dhe, veçanërisht, ato që lidhen me shëndetin e individëve.

Përpunimi në fjalë përfshin, ndër të tjera, mbledhjen e të dhënave të nevojshme në lidhje me realizimin e survejancës epidemiologjike, ruajtjen e këtyre të dhënave në përputhje afatet ligjore të zbatueshme, shkëmbimin dhe transmetimin e tyre midis organeve në fjalë dhe kontrolluesve të tjerë publikë e privatë, etj.

Gjithashtu, në kuadër të masave kundër pandemisë botërore të shkaktuar në COVID-19, organet e angazhuara në luftën kundër COVID-19 mund të kenë të detyrueshme apo nevojshme transferimin ndërkombëtar të të dhënave në vende dhe/ose organizata ndërkombëtare të ndryshme, për qëllime statistikore, shkencore dhe/ose për qëllime analizimi më të specializuar të tyre.

Në këtë kontekst, Zyra e Komisionerit, vlerëson se kontrolluesit e sipërpërmendur duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e neneve 8 dhe 9 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilat rregullojnë dhe dispijlojnë transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Veprimtaria e përpunimit të të dhënave personale për qëllimet e përmendura këtu nuk përbën shkak për të kufizuar të drejtën e individëve për mbrojtje të të dhënave personale, siç parashikohet në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Siç përmendet më sipër, edhe në këtë rast gjejnë zbatim dispozitat e neneve 5, 6 dhe 7 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave personale, si dhe aktet nënligjore të Komisionerit (veçanërisht Udhëzimi nr. 49).

Më tej, vlen të theksohet se anonimizimi i të dhënave, si masë për ruajtjen e privatësisë, në kuadër të survejancës epidemiologjike, nuk passjell automatikisht kufizim të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, me pretekstin se kjo e drejtë pengon, apo nuk përputhet me qëllimin e survejancës epidemiologjike. Të dhënat e anonimizuara janë, gjithashtu, shprehimisht të rregulluara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale⁷.

Ky rregull është i zbatueshëm edhe në lidhje me përpunimin e të dhënave të vendndodhjes të përshkruar në pikën II më sipër.

IV. Përpunimi i të dhënave në sektorin e arsimit

Siç është publikisht e njohur tashmë, për shkak të masave kundër COVID-19, institucionet e arsimit parauniversitar dhe universitar nuk e kanë ndërprerë procesin e mësimdhënies, por e kanë vijuar atë nëpërmjet platformave *online*, në të cilat përpunohen të dhënat personale (ndër të tjera imazhe të regjistruara) të nxënësve, studentëve dhe stafeve pedagogjike të institucioneve arsimore.

Në lidhje me këtë aspekt, Zyra e Komisionerit vlerëson se në përdorimin dhe administrimin e platformave *online*, të cilat ofrojnë zgjidhje teknike që synojnë të sigurojnë vazhdimësinë e veprimtarisë arsimore, është e preferueshme të përzgjidhen konfigurime standarde të orientuara

⁷ Pika 3 e nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

drejt mbrojtjes së të dhënave personale, në mënyrë që të evitohet maksimalisht mundësia e cënimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave (nxënës, studentë, staf pedagogjik).

Edhe në këtë rast është jashtëzakonisht e rëndësishme të shmanget përpunimi i të dhënave personale në tejkalim të sasisë dhe/ose cilësisë së nevojshme për të arritur qëllimin e sigurimit të vazhdimësisë arsimore, në përputhje me nenin 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Gjithashtu, rëndësi themelore, në këtë aspekt, ka edhe përzgjedhja e kriterit ligjor të përpunimit të të dhënave (siç përcaktohet në nenin 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale), të subjekteve përkatëse të të dhënave.

Veçanërisht i rëndësishëm, në këtë aspekt, është rasti i fëmijëve, për të cilët Zyra e Komisionerit rekomandon fuqimisht marrjen e miratimit të prindit ose kujdestarit ligjor të fëmijës, në lidhje përpunimin e të dhënave në kontekstin e mësimdhënies *online*.

Detyrimi i sipërpërmendur duhet të shoqërohet, më tej, me informimin plotësisht transparent (dhe, mundësisht, shterues) të prindërve ose kujdestarëve ligjorë, në lidhje me aspektet e përpunimit të të dhënave të fëmijëve, në zbatim të dispozitave të nenit 18 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Si në të gjitha rastet e tjera të trajtuara në këtë udhëzues, Zyra e Komisionerit thekson se përpunimi i të dhënave në sektorin e arsimit, në kushtet e distancimit social të imponuar nga masat kundër COVID-19, duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e legjisllacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe atë sektorial.

Zyra e Komisionerit do të vijojë të japë orientime për kontrolluesit publikë dhe privatë, si dhe për subjektet e të dhënave personale, në lidhje me interpretimin dhe zbatimin sa më të drejtë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të masave kundra COVID-19, me qëllim mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe, sigurisht, të të dhënave personale të qytetarëve.

Siguria e bashkëqytetarëve mbetet shqetësimi ynë kryesor.